



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosova

## **KODI I ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË STOMATOLOGJIKE**

Prishtinë, nëntor 2024

**KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TE KOSOVËS**, në mbështetje të Nenit 9, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenin 19, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë; Nenin 14, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenin 20, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.2 të Statutit të OSK-së si dhe Nenin 18, paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OSK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 16 maj 2019, në mbledhjen e rregullt të datës 25.11.2024, miraton:

## **KODIN E ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË STOMATOLOGJIKE**

### **I. DISPOZITAT e PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Subjekti dhe Qëllimi**

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike (në tekstin e mëtejme: Kodi) përcakton parimet, rregullat, standardin e sjelljes profesionale dhe etikën, të cilat anëtarët e Odës së Stomatologëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Oda) janë të detyruar t'i përmbahen. Qëllimi i Kodit është të ruajë lirinë dhe reputacionin e profesionit mjekësor, të ngritë cilësinë e shërbimeve stomatologjike dhe të forcojë besimin midis doktorit të stomatologjisë dhe pacientëve, duke respektuar konceptin e autonomisë dhe të drejtave të pacientit.

#### **Neni 2**

##### **Barazia gjinore**

Termat e përdorur në Kod, e që kanë një kuptim gjinor, pavarësisht nëse përdoren në gjininë mashkullore apo femërore, përfshijnë gjininë mashkullore dhe femërore në mënyrë të barabartë.

#### **Neni 3**

##### **Njohja e e legjislacionit**

Çdo doktor i stomatologjisë duhet të njohë dhe respektojë legjislacionin në fushën e shëndetësisë, Statutin dhe aktet tjera normative të Odës.

#### **Neni 4**

##### **Këshilli Etik i Odës së Stomatologëve të Kosovës**

Këshilli Etik i Odës së Stomatologëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli) kujdeset për zbatimin e Kodit në përputhje me ligjet e shtetit të Republikës së Kosovës dhe statutin e Odës, dhe në veçanti duke marrë parasysh çështjet etike që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbikëqyrja e parimeve të etikës profesionale me qëllim që të sigurohet sjellja etike e anëtarëve të Odës dhe kryerja e detyrave të tjera që lidhen me zbatimin e Kodit.

## **II. PARIMET THEMELORE**

### **Neni 5**

#### **Parimi i ndërgjegjshmërisë**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të kryejë veprimtarinë e tij profesionale me ndërgjegje, sipas rregullave të profesionit mjekësor dhe me kujdesin e nevojshëm, në përputhje me parimet e etikës mjekësore dhe deontologjisë dhe parimet e njerëzimit.

### **Neni 6**

#### **Parimi i barazisë**

Doktori i stomatologjisë ofron kujdesin shëndetësor në mënyrë të barabartë për të gjithë pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, kombësia, feja ose opinioni politik dhe statusi shoqëror, gjuha, kultura, lloji i sëmundjes, paaftësia mendore ose fizike ose tipare të tjera personale, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e njeriut.

### **Neni 7**

#### **Parimi i respektimit të autonomisë dhe të drejtave të pacientëve**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të respektojë të drejtat, liritë, autonominë dhe dinjitetin njerëzor të secilit pacient, si dhe të udhëhiqet në punën e tij nga parimet e bamirësisë dhe parimet e drejtësisë.

### **Neni 8**

#### **Parimi i ruajtjes së integritetit profesional**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të ruajë integritetin dhe dinjitetin profesional.

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të ruajë me të gjitha aftësitë e tij traditën fisnike të profesionit mjekësor, duke ruajtur standarde të larta të punës profesionale dhe sjelljes etike ndaj pacientit dhe të afërmëve të tij, si dhe ndaj shoqërisë.

## **III. DOKTORI I STOMATOLOGJISË DHE ETIKA MJEKËSORE**

### **A. Detyrat themelore të doktorit të stomatologjisë**

#### **Neni 9**

Detyra e doktorit të stomatologjisë është që me profesionin e tij t'i përkushtohet shëndetit oral dhe të përgjithshëm të njeriut, duke i'u përmbajtur standardeve të shkencës mjekësore dhe parimeve etike.

#### **Neni 10**

Doktori i stomatologjisë duhet të jetë i vetëdijshëm për aftësitë dhe mundësitë e tij profesionale dhe nuk duhet t'i kalojë ato.

#### **Neni 11**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar që të marrë pjesë në edukimin e vazhdueshëm profesional. Njohuritë e fituara profesionale duhet t'i përcjellë te kolegët dhe profesionistët tjerë shëndetësorë.

#### **Neni 12**

Doktori i stomatologjisë duhet të rekomandojë vetëm ato procedura diagnostike ose terapeutike që konsideron të jenë të dobishme për pacientin dhe në përputhje me standardet e shkencës mjekësore, etikës dhe deontologjisë. Gjatë trajtimit të pacientit, doktori i stomatologjisë duhet të evitojë ekzaminimet dhe procedurat e panevojshme, të cilat mund t'i shkaktojnë shpenzime ekonomike të paarsyeshme, pavarësisht se kush i bart shpenzimet e trajtimit të pacientit.

#### **Neni 13**

Doktori i stomatologjisë e bën diagnostikimin dhe trajtimin stomatologjik të pacientit, në parim, vetëm me pëlqimin e tij, që mund të jepet me shkrim ose me gojë. Kjo dispozitë e këtij neni nuk do të zbatohet për një pacient me aftësi të kufizuara mendore, nëse nuk ka pëlqimin e kujdestarit ose të përfaqësuesit ligjor. Nëse pacienti është nën moshën 18 vjeçare, intervenimi stomatologjik mund të bëhet me pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor (prindi, prindi adoptues ose kujdestari), me përjashtim të rasteve urgjente. Doktori i stomatologjisë është i detyruar ta informojë pacientin për pasojat për shëndetin e tij në rast të refuzimit të masës mjekësore të propozuar.

#### **Neni 14**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të ofrojë ndihmë mjekësore urgjente.

#### **Neni 15**

Puna në rast të rrethanave të jashtëzakonshme është një detyrim i veçantë për një doktor të stomatologjisë. Ai duhet të njohë parimet moderne të doktrinës së punës në rrethana të jashtëzakonshme.

#### **Neni 16**

Në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve që rrezikojnë drejtpërdrejtë jetën e pacientit, doktori i stomatologjisë është i detyruar të ndër marrë ndërhyrje dhe të veprojë në përputhje me njohuritë, përvojën ekzistuese dhe rrethanat.

#### **Neni 17**

Doktori i stomatologjisë duhet t'i respektojë të drejtat e pacientit, kolegëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësorë si dhe rregullat e institucioneve shëndetësore.

#### **Neni 18**

Doktori i stomatologjisë, duhet të raportojë tek organet kompetente të Odës për punën e personave që e ushtrojnë aktivitetin stomatologjik në mënyrë joprofesionale ose në kundërshtim me ligjin.

#### **Neni 19**

Doktorit të stomatologjisë përveç ushtrimit të profesionit të stomatologut, nuk i ndalohet ushtrimi i ndonjë veprimtarie tjetër, që përputhet me parimet etike të profesionit të tij.

#### **Neni 20**

Doktorit të stomatologjisë nuk i lejohet të abuzojë me prioritetet dhe përparësitë që i krijojnë statusi i tij profesional ndaj pacientit, për qëllime përfitimi personal dhe profesional.

Doktori i stomatologjisë, madje edhe jashtë ushtrimit të profesionit duhet të ruajë të pastër figurën e tij morale, duke shmangur çdo akt që do të zhvlerësonte personalitetin dhe dinjitetin e tij njerëzor e profesional.

### **B. Privatësia dhe konfidencialiteti**

#### **Neni 21**

Doktori i stomatologjisë duhet të ruajë të dhënat personale dhe shëndetësore të pacientit. Doktori i stomatologjisë është i detyruar të mbajë si fshehtësi profesionale gjithçka që mëson për gjendjen shëndetësore të pacientit dhe jo vetëm. Ai është i detyruar të kujdeset që fshehtësia profesionale të ruhet edhe prej personave të tjerë që punojnë me të.

#### **Neni 22**

Fshehtësia profesionale përfshin të gjitha informacionet që ka doktori i stomatologjisë gjatë kryerjes së profesionit, për pacientin, rrethanat personale, familjare dhe shoqërore, si dhe informacionin lidhur me zbulimin, trajtimin dhe shërimin e sëmundjes.

#### **Neni 23**

Doktori i stomatologjisë duhet të mundësojë qasjen në dokumentacionin mjekësor nëse pacienti e kërkon këtë. Doktori i stomatologjisë nuk duhet të përmendë emrin e pacientit në publik në mënyrë që të mos rrezikohet privatësia e pacientit.

#### **Neni 24**

Zbulimi i fshehtësisë profesionale lejohet vetëm me pëlqimin e pacientit dhe që është në dobi të pacientit dhe familjes së tij. Zbulimi i një fshehtësie profesionale lejohet gjithashtu në rast se do të rrezikonte jetën dhe shëndetin e personave të tjerë.

#### **Neni 25**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të mbajë fshehtësinë profesionale për pacientin dhe për anëtarët e familjes së pacientit, edhe pas vdekjes së tij.

#### **Neni 26**

Të dhënat mbi rezultatet e hulumtimit mund të përdoren në studimet e kërkimit shkencor, por vetëm në rast se ruan anonimitetin e pacientit. Prezantimi publik i pacientit me qëllim të hulumtimit shkencor dhe profesional është i mundur vetëm me pëlqimin e pacientit.

#### IV. NORMAT ETIKE NË RAPORT ME PACIENTIN

##### Neni 27

Doktori i stomatologjisë duhet ta kryejë punën e tij në mënyrë profesionale dhe etike, pa e shfrytëzuar pacientin në aspektin emocional, fizik apo material.

##### Neni 28

Doktori i stomatologjisë respekton të drejtën e pacientit për të zgjedhur mjekun.

##### Neni 29

Të afërmit e pacientëve apo persona të tjerë mund të jenë të pranishëm gjatë kontrollit dhe trajtimit, nëse doktori i stomatologjisë e jep pëlqimin e tij në raste të caktuara.

##### Neni 30

Gjatë referimit të pacientëve te kolegët apo institucione të tjera shëndetësore, doktorët e stomatologjisë duhet të përcjellin me kohë të gjitha të dhënat lidhur mbi trajtimin e deritanishëm. Dokumentet origjinale duhet të kthehen te mjeku referues.

##### Neni 31

Doktori i stomatologjisë nuk ka të drejtë ta keqpërdorë dokumentacionin e pacientit në favor të vetin.

##### Neni 32

Pacienti ka të drejtë të refuzojë me shkrim procedurat terapeutike dhe masat e parapara mjekësore të propozuara nga doktori i stomatologjisë, përkundër informimit të drejtë dhe me kohë për sëmundjen dhe rrezikun për shëndetin e tij.

##### Neni 33

Komunikimi i mirë është thelbësor në marrëdhëniet doktor i stomatologjisë - pacient. Doktori i stomatologjisë duhet t'ia mundësojë pacientit ose përfaqësuesit ligjor të pacientit që të marrë informatat rreth trajtimit të tij. Doktori i stomatologjisë duhet të ofrojë informata rreth trajtimit të propozuar, opsioneve të tjera të trajtimit, rreziqeve të mundshme, gjithashtu edhe rreth çmimit, në mënyrë që t'ia mundësojë pacientit të bëjë një zgjedhje të duhur.

##### Neni 34

Doktori i stomatologjisë duhet të mbajë të dhëna/shënime të duhura (si dhe të dhënat e regjistruara në mënyrë elektronike) shëndetësore-stomatologjike, dhe personeli stomatologjik të jetë në dijeni për obligimin e vet që ta ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të pacientit.

##### Neni 35

Çdo dokument që plotëson dhe lëshon doktori i stomatologjisë, duhet të hartohet në mënyrë korrekte, plotësisht në përputhje me konstatimet mjekësore, të jetë i lexueshëm, ku mund të identifikohet nënshkrimi dhe faksimili i tij.



### **Neni 36**

Çdo pasaktësi dhe mospërputhje me konstatimet mjekësore dhe abuzimi në përshkrimin dhe lëshimin e dokumenteve mjekësore, përbën objekt ndjekjeje dhe përballjeje me proceset e gjyqimit disiplinor profesional dhe juridik për doktorin e stomatologjisë.

### **Neni 37**

Regjistrimet-shënimet mjekësore stomatologjike duhet të ruhen në kohëzgjatje prej pesë viteve pas përfundimit të trajtimit, përderisa nuk ekziston një afat më i gjatë i ruajtjes sipas akteve ligjore.

### **Neni 38**

Pacienti duhet të informohet për shëndetin e tij oral bazuar në fakte të vërteta dhe të verifikuara.

### **Neni 39**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të jetë i besueshëm dhe i sinqertë me pacientët e tij, duke parandaluar pritjet joreale të pacientit pas përfundimit të trajtimit.

### **Neni 40**

Nëse nevojat e trajtimit të pacientit i tejkalojnë mundësitë, njohuritë dhe aftësitë e doktorit të stomatologjisë, ai duhet të referohet për mjekim te një koleg tjetër, pra në një institucion shëndetësor, i cili mund t'i plotësojë kushtet për trajtimin e duhur.

### **Neni 41**

Doktori i stomatologjisë ka të drejtë të refuzojë trajtimin, por ta referojë pacientin te një stomatolog tjetër, nëse ai konsideron se nuk ka përvojë të mjaftueshme profesionale, nuk ka mundësi teknike për trajtim të suksesshëm, nuk ka një marrëdhënie të besimit të plotë të pacientit në punën e tij, apo pacienti refuzon të bashkëpunojë. Refuzimi i trajtimit nuk vlen për rastet urgjente.

### **Neni 42**

Nëse një pacient është i njoftuar me gjendjen e tij dhe mund të merr vendim të pavarur, por nuk vepron në përputhje me rekomandimet e doktorit të stomatologjisë për trajtimin dhe parandalimin e sëmundjes, doktori i stomatologjisë mund të refuzojë kujdesin e mëtejshëm për të, por me kusht që ai të referohet te një koleg tjetër ose institucion tjetër shëndetësor.

### **Neni 43**

Procedura e paragrafit paraprak të këtij neni zbatohet edhe në rastet kur pacienti sillet në mënyrë të papërshtatshme, fyese ose kërcënön, por kjo përjashtohet vetëm në rastet kur pacienti nuk është në rrezik për jetën, sepse atëherë ai ka nevojë për ndihmë pavarësisht nga sjellja e tij.

#### **Neni 44**

Përveç shpërblimit të rregullt për punën mjekësore, në formën e pagës ose honorarit, një tjetër përfitim material ose ndonjë përfitim tjetër nga puna e tij mjekësore, si dhe kushtëzimi i ofrimit të një shërbimi shëndetësor me një dhuratë është në kundërshtim me këtë Kod.

### **V.      NORMAT ETIKE NDËRKOLEGIALE**

#### **Neni 45**

Doktori i stomatologjisë duhet të sillet ndaj kolegëve të tij me korrektësi e ndershmëri, duke ruajtur e duke mos cënuar dinjitetin e asnjërit, ashtu siç do të dëshironte, që ata të sillëshin ndaj tij. Doktori i stomatologjisë nuk lejohet të përgojojë kolegët e tij, me qëllim që të ulë autoritetin dhe personalitetin e tyre përpara të sëmurëve dhe publikut, duke i dëmtuar në ushtrimin e profesionit, si dhe në marrëdhëniet dhe besimin e pacientëve ndaj tyre. Asnjë mosmarrëveshje midis kolegëve nuk duhet të çojë në polemika publike, ato duhet të zgjidhen vetëm në rrugën e pajtimit, në rast nevojë edhe me ndërmjetësinë e autoriteteve institucionale apo organeve të Odës.

#### **Neni 46**

Doktori i stomatologjisë duhet të jetë gjithë jetën mirënjohës dhe të tregojë respekt dhe mirësjellje ndaj mësuesve të tij për dijet dhe aftësitë profesionale, që ka fituar nga ata. Mungesa e mirënjohjes dhe e respektit ndaj mësuesve është e pafalshme dhe e dënueshme moralisht.

#### **Neni 47**

Çdo doktor i stomatologjisë e ka për detyrë të ruajë dhe respektojë solidaritetin me kolegët, në të mirë të ruajtjes së integritetit profesional dhe në respekt të normave të etikës dhe deontologjisë stomatologjike. Në qoftë se një doktor i stomatologjisë ikërkohet një këshillë, ose ndihmë profesionale nga një koleg, ai duhet të jetë i gatshëm t'i japë ato me sinqeritet dhe në përputhje me njohuritë më të mira që zotëron. Është në moralin dhe nderin e çdo doktori të stomatologjisë ta marrë në mbrojtje një koleg, në qoftë se ai është sulmuar dhe vënë nën akuzë në mënyrë të padrejtë.

#### **Neni 48**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar të mos heshtë dhe të mos qëndrojë indiferent përpara gabimeve që mund të bëhen nga bashkëpunëtorët, ose personeli tjetër ndihmës. Ai duhet t'i trajtojë ato me takt, pa cënuar dinjitetin e asnjërit dhe asnjëherë në prani të pacientit, familjarëve, apo personave të tjerë.

#### **Neni 49**

Në rast se doktori i stomatologjisë vihet në dijeni të një sjelljeje të padenjë të një kolegu, që nuk përputhet me normat e etikës mjekësore stomatologjike, ai e ka për detyrë t'ia vë në dijeni këtë vetëm kolegut të tij dhe autoriteteve drejtuese të institucionit dhe/ose organeve të Odës. Atij nuk i lejohet të diskutojë për këtë me pacientin, me familjarët apo me kolegë dhe persona të tjerë.



#### **Neni 50**

Doktori i stomatologjisë do të mbrojë kolegët e vet, të cilët janë fajësuar në mënyrë të pabazë, sipas parimeve të kolegialitetit. Është i obliguar që të diskutojë me kolegë të tjerë dhe jo me pacientin, nëse ka vërejtur të ndonjë koleg papërshtatshmëri morale, etike, ose gabim në diagnostikim apo shërim. Nëse këto parregullsi nuk korrigjohen, atëherë ai do t'u drejtohet organeve përkatëse në Odë.

#### **Neni 51**

Mospajtimi në mendime profesionale nuk duhet të cenojë rregullat e sjelljes së mirë. Në rast se kolegët nuk mund t'i korrigjojnë mospajtimit e ndërsjella, atëherë ata duhet t'i drejtohen organeve përkatëse të Odës.

#### **Neni 52**

Bashkëpunimi me anëtarë të profesioneve të tjera shëndetësore lejohet nëse fushat e përgjegjësive së doktorëve të stomatologjisë dhe anëtarit të profesionit tjetër shëndetësor mbahen qartë të ndara nga njëra-tjetra.

#### **Neni 53**

Raportet midis kolegëve duhet të bazohen në respektin, korrektësinë, ndershmërinë dhe shkëmbimin e përvojave. Në të njëjtën kohë, ata duhet të respektojnë përvojën profesionale të kolegëve më të vjetër, të cilët duhet të jenë model për stomatologët e rinj.

#### **Neni 54**

Doktori i stomatologjisë është përgjegjës për trajtimin mjekësor; megjithatë, ai duhet të respektojë ekspertizën dhe mendimin e kolegëve të tij me anë të cilave ata pranojnë të ndajnë bashkërisht përgjegjësinë profesionale. Hierarkia profesionale duhet të respektohet; megjithatë, duhet të ketë edhe një shkëmbim të vazhdueshëm të dyanshëm të informacionit dhe përvojës.

#### **Neni 55**

Mosmarrëveshjet e ndërsjella në pikëpamjet profesionale të doktorëve të stomatologjisë nuk duhet të shkaktojnë sjellje të papërshtatshme dhe të shkelin parimet etike.

### **VI. NORMAT ETIKE TË DOKTORIT TË STOMATOLOGJISË ME ODËN**

#### **Neni 56**

Anëtarët e Odës kanë të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të barabarta në Odë.

#### **Neni 57**

Anëtari i Odës është i detyruar t'i përmbushë me ndërgjegje obligimet që i ka ndaj Odës, të respektojë, të ruajë dhe të ngritë reputacionin, si dhe të kontribuojë në punën më të suksesshme të Odës.

#### **Neni 58**

Pavarësisht institucionit publik apo privat në të cilin punon, si dhe pozicionit hierarkik apo social të cilit i përket, doktori i stomatologjisë është i detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë nga Oda, për t'u paraqitur për një proces gjykimi disiplinor profesional, çfarëdo informacioni dhe bashkëpunimi që i kërkohet nga Oda.

### **VII. NORMAT ETIKE TË DOKTORIT TË STOMATOLOGJISË NË RAPORT ME SHOQËRINË**

#### **Neni 59**

Doktori i stomatologjisë duhet të jetë i vetëdijshëm për natyrën sociale të profesionit të tij, prandaj duhet të mbështeten dhe promovohen masat për përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm, veçanërisht shëndetit oral të popullatës.

#### **Neni 60**

Doktori i stomatologjisë nuk mund të përdorë një titull profesional, shkencor apo akademik, që nuk është fituar në përputhje me rregulloret përkatëse ligjore.

#### **Neni 61**

Doktorit të stomatologjisë nuk i lejohet të publikojë falenderime publike në marrëveshje me pacientin ose familjen e tij përmes mediave të ndryshme.

#### **Neni 62**

Doktori i stomatologjisë nuk mund të kërkojë apo të pranojë dhurata apo favore financiare nga kompani apo individë që tregëtojnë barna, pajisje apo materiale të tjera mjekësore-stomatologjike, me përjashtim të financimeve me bazë ligjore vetëm për veprimtari të akredituara, të cilat organizohen në funksion të edukimit të vazhdueshëm profesional. Kushtet dhe përmasat e sponsorizimit duhet të parashtrihen haptas gjatë njoftimit dhe zbatimit të veprimtarisë së akredituar.

#### **Neni 63**

Doktori i stomatologjisë, madje edhe jashtë ushtrimit të profesionit duhet të ruajë të pastër figurën e tij morale, duke shmangur çdo akt që do të zhvlerësonte personalitetin dhe dinjitetin e tij njerëzor e profesional.

#### **Neni 64**

Në rastet e akuzave publike të një rasti kontestues, doktori i stomatologjisë ka të drejtë dhe detyrë të mbrojë reputacionin e tij dhe të kolegëve.

## **VIII. REKLAMIMI I SHËRBIMEVE STOMATOLOGJIKE NGA DOKTORI I STOMATOLOGJISË**

### **Neni 65**

Doktori i stomatologjisë mund të reklamojë kryerjen e shërbimeve stomatologjike përmes internetit në përputhje me udhëzimet e Bashkimit Evropian.

Reklamimi i shërbimeve stomatologjike në internet lejohet për të siguruar konkurrencën dhe liberalizimin e tregut, në përputhje me udhëzimet e Bashkimit Evropian.

### **Neni 66**

Doktori i stomatologjisë nuk mund të reklamojë në mënyrë të rreme ose mashtruese.

Termi i rremë dhe mashtrues nënkupton paraqitje materiale të gabuar të fakteve, mosparaqitje të fakteve të rëndësishme, duke deklaruar fakte që krijojnë një pritje të pajustificuar të rezultateve, apo paraqitjet se shërbimet e reklamuar janë të një cilësie më të mirë se të anëtarëve tjerë të Odës.

### **Neni 67**

Doktorit të stomatologjisë rreptësisht i ndalohet të përdorë prezantimet e pacientëve për të promovuar aktivitetet e tij, duke bërë publik dokumentacionin mjekësor të pacientëve me qëllim promovimi.

Përdorimi i fotografive të zgavrës së gojës të pacientit përmes internetit lejohet vetëm me pëlqimin me shkrim të pacientit dhe pa zbuluar identitetin e pacientit.

### **Neni 68**

Doktori i stomatologjisë e ka kategorikisht të ndaluar reklamimin, publikimin e çmimeve në media elektronike, atë të shkruar, vizive, televizive dhe radiofonike, për arsye përfitimi.

## **IX. INFORMATAT PROFESIONALE, PERSONALE DHE KOMUNIKIMI ELEKTRONIK**

### **Neni 69**

Të vetmet informata që i lejohen doktorit të stomatologjisë të paraqesë në dokumentat dhe njoftimet e ndryshme që publikon si dhe në hyrje të kabinetit të tij janë:

- Emri i institucionit, adresa, numri i telefonit dhe orari i punës.
- Emri dhe mbiemri i doktorit të stomatologjisë.
- Thirrja profesionale.
- Thirrja akademike apo thirrja shkencore nëse stomatologu posedon.

## **Neni 70**

### **Kërkesat për informacion profesional gjatë komunikimit komercial**

Kur doktori i stomatologjisë ofron informacion profesional përmes internetit, duhet të tregojë vërtetësi, drejtësi dhe dinjitet. Gjatë krijimit të një faqeje interneti, doktori i stomatologjisë duhet të sigurojë që përmbajtja të mos përmbajë informacione joprofesionale, veçanërisht të një natyre tepër lavdëruese, mashtruese ose krahasuese.

## **Neni 71**

### **Informacionet e detyrueshme të ofruesit në një faqe interneti**

Në faqen e internetit të një institucioni të kujdesit stomatologjik duhet të jenë këto informata:

- 71.1 Emri dhe adresa e institucionit, në të cilën ndodhet ofruesi i shërbimeve;
- 71.2 Detajet e ofruesit të shërbimeve, orari i punës, nr. i telefonit; duke përfshirë e-mail adresën, nr. telefonit (faks);
- 71.3 Thirrja profesionale;
- 71.4 Thirrjet akademike apo shkencore nëse stomatologu posedon;
- 71.5 Licenca dhe informata mbi regjistrimi dhe detaje të kontakteve të autoritetit kompetent.

## **Neni 72**

### **Informatat që mund të paraqiten në një faqe interneti:**

- 72.1 Detajet e kujdesit emergjent që është në dispozicion në klinikë;
- 72.2 Detajet e shërbimeve të ofruara nga doktori i stomatologjisë përgjegjës ose nga mjekët e tjerë në klinikë ose në lokacione të tjera;
- 72.3 Linkun e Odës së Stomatologëve të Kosovës. Nëse ka linqe për faqe të tjera, doktori i stomatologjisë duhet të sigurojë që ato të jenë të rëndësishme dhe që ato reflektojnë parimet e këtij kodi.

## **Neni 73**

### **Informacionet që nuk duhet të vendosen në faqen e internetit:**

- 73.1 Krahasimi i aftësive dhe kualifikimeve ndërmjet doktorëve të stomatologjisë që ofrojnë shërbime stomatologjike.
- 73.2 Renditja e kolegëve në faqet e internetit për interesat e tyre komerciale.

## **X. HULUMTIMET BIOMJEKËSORE**

### **Neni 74**

Doktori i stomatologjisë që ndërmerr hulumtime në fushën e biomjekësisë duhet të bazohet në parimet e këtij Kodi që rrjedhin nga Deklarata e Helsinkit dhe rishikimeve të saj; Praktika e Mirë Klinike; legjislacioni në fuqi, si dhe në përputhje me protokolet e miratuara nga organi kompetent i Odës.

### **Neni 75**

Doktori i stomatologjisë, që merr përsipër një punë kërkimore me qëllim hulumtues, parandalues, diagnostikues apo mjekues, ku përfshihen të sëmurë apo vullnetarë, detyrimisht paraqet projektin përpara një komisioni të posaçëm, kompetent e të pavarur, për të vlerësuar dhe miratuar bazën shkencore dhe pranueshmërinë etike.

### **Neni 76**

Doktori i stomatologjisë që kryen hulumtimin është i detyruar t'i informojë personat që janë të përfshirë në projektin hulumtues në detaje për qëllimin e punës, përfitimet e pritshme dhe rreziqet e mundshme, dhe të marrë pëlqimin e tyre me shkrim.

Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të moshës së mitur, paaftësisë ose gjendjes së vetëdijes së personit, kërkohet pëlqimi nga prindi, përfaqësuesi ose kujdestari i tij / saj ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 77**

Përshtatja, kryerja dhe nxitja e metodave të pavërtetuara shkencërisht që ngjallin shpresë të rrejshme te pacientët dhe familjarët e tyre, është e ndaluar dhe përbën shkelje të rëndë të Kodit etik dhe deontologjisë stomatologjike.

## **XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 78**

Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Odës që ushtrojnë veprimtarinë stomatologjike, në territorin e Republikës së Kosovës.

Çdo anëtar i Odës është i detyruar të njihet me dispozitat e këtij Kodi dhe t'i zbatojë ato.

### **Neni 79**

Çdo akt mjekësor, apo sjellje profesionale në kundërvajtje me dispozitat e këtij Kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin për Odat e Professionistëve Shëndetësorë Nr.04/L-150. dhe në Rregulloren për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyerjes etike dhe profesionale. Këshilli Etik dhe Gjyqi i Nderit janë organe kompetente për sanksionimin në rast të shkeljes së dispozitave të këtij Kodi.

#### **Neni 80**

Kryerja e detyrave që lidhen me veprimtarinë stomatologjike, e që nuk lidhen drejtpërdrejtë me trajtimin e pacientëve dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor stomatologjik për pacientin nuk konsiderohen shkelje të dispozitave të Kodit.

#### **Neni 81**

Anëtari i Odës ka të drejtën dhe detyrimin që të raportojë në organin kompetent të Odës për çdo shkelje të dispozitave të këtij Kodi.

#### **Neni 82**

Përveç dispozitave të këtij Kodi, doktorët e stomatologjisë janë të detyruar t'i përmbahen parimeve etike ndërkombëtare, si Kodit të Etikës për stomatologët e Bashkimit Evropian, parimeve etike, deklaratave dhe rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe dispozitave të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

#### **Neni 83**

Oda është e detyruar të harmonizojë aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij Kodi brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi.

#### **Neni 84**

Këshilli Etik i Odës është i autorizuar të interpretojë këtë Kod.

#### **Neni 85**

Me miratimin e këtij Kodi shfuqizohet Kodi Etik për Doktorët e Stomatologjisë i miratuar nga Kuvendi i Odës së Stomatologëve i datës 30 Maj 2015.

#### **Neni 86**

Ky Kod hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit të tij në faqen e internetit të Odës.

Prishtinë,  
25.11.2024



Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Prof. Dr. Blerim Kamberi